



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Shtator 2022

9

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NIS ZBATIMIN I PARI PROGRAM KODIMI NË SHQIPËRI PËR FËMIJËT QË NË KLASË TË PARË

Me 12 shtator ka filluar zbatimi i **kurikulës së kodimit në klasa të para**, në **100 shkolla të arsimit bazë publik** të vendit që janë të pajisura me **laborator të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit**. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Arsimit dhe Sportit, bashkë me kryeministrin e vendit, Edi Rama, prezantuan këtë risi nga inaugurimi i laboratorit digjital, në shkollën 9-vjeçare "Jeronim De Rada".

Ky program **do të zbatohet nga Qeveria shqiptare në bashkëpunim me Fondacionin Amerikano-Shqiptar për Zhvillim (AADF)**, të cilët do të sigurojnë që të gjithë njohuritë që përfshihen si pjesë e kurikulës, që të jenë në linjë me kërkesat e një tregu gjithmonë e në zhvillim. Ndër të tjera, ky program synon që fëmijët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të **përdorur teknologjinë në mënyrë kuptimplotë dhe produktive**, jo thjesht përdorues pasiv. Si dhe të zhvillojnë më tepër të **menduarit kritik dhe logjikën**, nëpërmjet metodave interaktive.

MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT BASHKËDREJTON MBLEDHJEN E PARË TË BORDIT KËSHILLIMOR PËR PROJEKTIN RAJONAL ME UNDP DHE UNFPA

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët bashkë me koordinatoren e Përherëshme të OKB-së në Shqipëri, Fiona McCluney, **drejtuan mbledhjen e parë të Bordit Shqiptar Këshillimor** për zbatimin e projektit rajonal "Fuqizimi i rolit të rinjve për promovimin e mirëkuptimit reciprok, narrativës konstruktive, respektit për diversitetin dhe rritjes së besimit, **në Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi**". Roli i Bordit Këshillimor të Projektit në Shqipëri ka si përgjegjësi **të mbikëqyrë dhe të japë këshilla** që udhëheqin zbatimin e drejtë të projektit në vend.

Ky projekt rajonal **synon të fuqizojë të rinjtë e Ballkanit Perëndimor** që të përfshihen në ndërtimin e narrativave konstruktive, në fuqizimin e dialogut ndër-kulturor, **të sigurojnë gjithëpërfshirje, barazi gjinore dhe të krijojnë besim reciprok mes tyre**. Projekti në Shqipëri zbatohet nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara, UNFPA dhe UNDP, me financim të Fondit së Kombeve të Bashkuara për Paqen.



ZHVILLOHEN TAKIME ME TË RINJËTË NË QYTETE TË NDRYSHME TË SHQIPËRISE

Përgjatë javës së fundit të shtatorit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët bashkë me përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) **kanë vizituar nga afër të rinjtë e Fierit**, të cilët patën mundësinë **të njihen me anëtarët e Këshillit Vendor Rinor** të këtij qyteti dhe me **nismat që janë ndërmarrë** për t'iu ofruar atyre më tepër mundësi angazhimi.

Vizita tjetër u zhvillua në Shkodër për të takuar **të rinjtë gjimnazistë, studentë dhe aktivistë të shoqërisë civile**, me të cilët u bisedua gjatë për **mbështetjen që Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët jep për ta** dhe çfarë mund të bëhet më shumë për të rinjtë e Shkodrës, dhe jo vetëm. Pjesë e kësaj mbledhjeje ishin edhe punonjësit e Zyrës Vendore Arsimore të Shkodrës dhe ato të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Shtator 2022

9

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MIKPRET TË DËRGUARIN SPECIAL TË GJERMANISË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, të mërkurën e 28 shtatorit, ka mirëpritur të **dërguarin special të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin**. Në takim zyrtar që u mbajt brenda ambienteve të Kryeministrisë u diskutua rreth **bashkëpunimeve të mëtejshme mes dy shteteve në sektorin e rinisë dhe përfshirjes së praktikave më të mira evropiane në vendin tonë**, sa i përket mbështetjes së ideve të të rinjve.

Angazhimi i mëtejshëm i ministrit përgjegjës për Rininë në Zyrën Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO), me qëllim promovimin e shkëmbimeve rinore në programet si "Super-shkollat", "Route WB6", etj., ishte një nga çështjet e rëndësishme primare të diskutuara në takim.

Po ashtu, iu dha një fokus i veçantë dhe projekteve kulturore për të rinjtë, ku u prezantua në terma të përgjithshme dhe **Programi Jashtë Orarit të Mësimin (JOM)** i hartuar me qëllim që fëmijët të shpenzojnë kohën e tyre të lirë në mënyrë cilësore, lidhur me fushën e arteve, zejeve, teknologjisë, etj..

"RINCAMP" MBLEDH 100 TË RINJ NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA PËR 3 DITË PLOT AKTIVITETE

100 të rinj nga Shqipëria dhe Kosova u mbledhën, përgjatë 3 ditëve të para të shtatorit, në eventin e përmasave të mëdha **"RinCamp 2022"**, ku u diskutua mbi **këshillimin e karrierës, barazinë gjinore në sytë e të rinjve dhe të drejtat themelore të njeriut**. Edhe vullnetarizmi e aktivizimi rinor, si dhe rëndësinë e shëndetit mendor tek të rinjtë ishin çështje që ngjallën mjaft debat mes pjesëmarrësve.

RinCamp, i zhvilluar bashkë me ekipin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, me mbështetjen e UNICEF Albania, World Vision Albania, UNDP Albania dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor, shënjoi dhe **aktivitetin e parë me të rinjtë e Kosovës**. Kjo në kuadër të **marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e rinisë mes Shqipërisë dhe Kosovës** që nënshkrua mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në Shqipëri dhe ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, Hajrulla Çeku.



ADRESOHEN PROBLEMATIKAT E TË RINJVE NË SEANCËN DËGJIMORE TË GRUPIT TË DEPUTETËVE "MIQTË E FËMIJËVE"

Për të adresuar problematikat e **gjimnazistëve**, më 28 shtator, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në seancën dëgjimore me temë **"Të rinjtë aktivë adresojnë zërin e tyre në Kuvend"**, zhvilluar **nga Grupi i Deputetëve "Miq të Fëmijëve"** bashkë me Komitetin e Helsinkit,

Mbi **50 të rinj e të reja nga 13 shkolla të mesme** prezantuan nismat e tyre të mbështetur me peticione, të cilat kanë si objekt **forcimin e kontrollit parlamentar dhe marrjen e masave të natyrës legjislative**. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka theksuar **angazhimin maksimal për të çuar përpara peticionet dhe nismat ligjore** të iniciuara prej tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi